

	REPUBLIKA E KOSOVËS REPUBLIKA KOSOVA REPUBLIC OF KOSOVA KOMUNA E RAHOVECIT OPSTINA ORAHOVAC MUNICIPALITY OF RAHOVEC	
---	---	---

Për:	Grup i Operatorëve Ekonomik: SEMAKS SH.P.K.; Enggroup SH.P.K. , William Walker, 20000, Prizren Operatorëve Ekonomik Të gjitha palëve të interesuar
Nga:	Astrit Mullabazi, Menaxher i Zyrës së Prokurimit
Lënda:	VENDIM për Rishqyrtim të Kërkesës
Datë:	30.07.2026

Zyrtari Përgjegjës i Prokurimit i Komunës së Rahovecit, në mbështetje të nenit 108/A (paragrafi 10.1) të Ligjit Nr. 04/L-042 për Prokurimin Publik të Republikës së Kosovës, i ndryshuar dhe plotësuar me ligjin Nr. 04/L-237, ligjin Nr. 05/L-068 dhe ligjin Nr. 05/L-092, si dhe duke u bazuar në nenin 63 paragrafi 1 të Rregullores Nr. 001/2022 për Prokurim Publik, sa i përket **Kërkesës për Rishqyrtim** të datës: **28.07.2026**, të parashtruar nga Grup i Operatorëve Ekonomik: **SEMAKS SH.P.K.; Enggroup SH.P.K.**, me adresë në **Prizren**, lidhur me aktivitetin e prokurimit me titull: **Hartimi i projekteve të ndryshme**, me Numër të prokurimit: **623-26-2856-2-1-1**, Numër i brendshëm: **623-26-015-2-1-1**, nxjerr:

V E N D I M

- I. **REFUZOHET** e pa bazuar kërkesa e parashtruar nga Grup i Operatorëve Ekonomik: **SEMAKS SH.P.K.; Enggroup SH.P.K.**, me adresë në **Prizren**, lidhur me aktivitetin e prokurimit me titull: **Hartimi i projekteve të ndryshme**, me Numër të prokurimit: **623-26-2856-2-1-1**, Numër i brendshëm: **623-26-015-2-1-1**, kundër Njoftimit mbi Vendimin e AK-së, të datës: **23.07.2026**, të publikuar në ueb-faqe: <https://e-prokurimi.rks-gov.net>
- II. Autoriteti Kontraktues vendos të vazhdoj me Njoftim Mbi Vendimin e Autoritet Kontraktues për aktivitetin e prokurimit, me Numër të prokurimit: **623-26-2856-2-1-1**, Numër i brendshëm: **623-26-015-2-1-1**
- III. Ky vendim hyn në fuqi ditën e nënshkrimit dhe do të publikohet për të gjitha palët në platformën elektronik në adresën: <https://e-prokurimi.rks-gov.net>

A r s y e t i m

Grup i Operatorëve Ekonomik: **SEMAKS SH.P.K.**; **Enggroup SH.P.K.**, me adresë në **Prizren**, lidhur me aktivitetin e prokurimit me titull: **Hartimi i projekteve të ndryshme**, me Numër të prokurimit: **623-26-2856-2-1-1**, Numër i brendshëm: **623-26-015-2-1-1**, kundër Njoftimit mbi Vendimin e AK-së, të datës: **23.07.2026**, të publikuar në ueb-faqe: <https://e-prokurimi.rks-gov.net>, ka bërë Kërkesë për Rishqyrtim me datë: **28.07.2026**, sipas nenit 108/A, të Ligjit për Prokurimin Publik (LPP) me Nr. 04/L-042.

Baza Ligjore për Refuzim të Kërkesës

Ju sqarojmë se pretendimet e tua ankimor nuk qëndrojnë dhe janë të pabazuar, pasi që vlerësimi i ofertave është bërë konform Ligjit Nr. 04/042, Ligji për Prokurimin Publik

Autoriteti Kontraktues: Komuna e Rahovecit, ju ka Njoftuar juve si Operator Ekonomik ankues, sipas formularit **B42 Letër Standarde për tenderuesin e eliminuar**, ku kemi cekur:

Tenderi juaj është refuzuar për këto arsye:

ARSYETIM

Në pajtim me Nenin 87, paragrafin 2, nën paragrafin 2.8 dhe nenin 61, paragrafin 4, të Ligjit mbi Prokurimin Publik nr. 04/L-042, i ndryshuar dhe plotësuar me ligjin Nr. 04/L-237, ligjin Nr. 05/L-068 dhe Ligjin Nr. 05/L-092, vlera e ofruar nga OE është normalisht e ulët. Në pajtim me Nenin 3, konkretisht pika 3.2 të Rregullat për Tenderët Jo-Normalisht të Ulët, nenin 41 konkretisht neni 41.6 të Rregullores NR.001/2022 Për Prokurim Publik dhe nenin 61 konkretisht 61.4 ligjit të LPP-së.

Pas analizimit dhe shqyrtimit të Ofertës Financiare të dorëzuar nga GOE, Komisioni i Vlerësimit ka vlerësuar se në ofertën e dorëzuar në disa pozicioneve ju si GOE keni ofertuar me çmime abnormalisht të ulëta, konkretisht si më poshtë:

- Pozicioni **I.D.5 Hartimi i Projektit për Rregullimin e Nyjeve të Trafikut (Kryqëzimeve Rrugore)** ju keni vendosur çmimin 50.00 €/Copë;
- Pozicioni **I.D.6 Hartimi i Elaboratit të Shpronësimit për Projektet Rrugor** ju keni vendosur çmimin 20.00 €/km, ose 0.02€/m;
- Pozicioni **I.D.12 Punimi i Elaboratit Gjeomekanik** ju keni vendosur çmimin 15.00 €/m thellësi
- Pozicioni **I.E.8 Hartimi i Projektit Ideor – Impianti për Trajtimin e Ujërave të Zeza (deri 2500 Banorë Ekuivalent – PE)** ju keni vendosur çmimin 500.00 €/copë.
- Pozicioni **I.E.9 Hartimi i Projektit kryesor – Impianti për Trajtimin e Ujërave të Zeza (deri 2500 Banorë Ekuivalent – PE)** ju keni vendosur çmimin 600 €/copë.

Çmime këto të cilat janë trajtuar si çmime jo normalisht të ulëta, për të cilat në përputhje me nenin **3.2 të Rregullave për Tenderët Jo-Normalisht të Ulët** dhe nenin **41.6 të Rregullores Nr. 001/2022 për Prokurimin Publik**, Autoriteti Kontraktues, përmes Zyrtarit të Prokurimit, i ka kërkuar Operatorit Ekonomik sqarim me shkrim dhe zbërthim të detajuar të çmimeve të ofruara, duke përdorur formularin standard për tenderët jo-normalisht të ulët.

Pavarësisht kërkesës së dërguar dhe afatit të përcaktuar për përgjigje, Operatori Ekonomik nuk ka dorëzuar asnjë përgjigje apo sqarim lidhur me çmimet e identifikuar si jo-normalisht të ulëta.

Komisioni i Vlerësimit ka vepruar në përputhje me nenin 41.7 të Rregullores Nr. 001/2022 për Prokurimin Publik, i cili përcakton se:

"Operatori Ekonomik do t'i përgjigjet me shkrim Autoritetit Kontraktues. Nëse jo, tenderi do të refuzohet."

Mosdorëzimi i sqarimeve të kërkuara për tenderin jo-normalisht të ulët e pamundëson verifikimin e realizueshmërisë së çmimeve të ofertuar dhe përputhshmërisë së tyre me kërkesat e dosjes së tenderit. Për këtë arsye, dhe në pajtim me dispozitat ligjore të lartcekura, oferta e Operatorit Ekonomik konsiderohet e papranueshme dhe refuzohet.

Duke qenë se Operatori Ekonomik nuk ka ofruar sqarimet e kërkuara brenda afatit të përcaktuar, Komisioni i Vlerësimit nuk ka pasur mundësi të vlerësojë arsyeshmërinë dhe realizueshmërinë e çmimeve të ofruara. Rrjedhimisht, oferta e Operatorit Ekonomik refuzohet në pajtim me nenin 41.7 të Rregullores Nr. 001/2022 për Prokurimin Publik.

PËRGJIGJE PËR PRETENDIMET ANKIMORE TË GRUPIT TË OPERATORËVE
EKONOMIK
SEMAKS SH.P.K.& Enggroup SH.P.K

PËRGJIGJE PËR PRETENDIMIN ANKIMORE

Grupi i operatoreve ekonomik, pretendon se elimini i ofertës së tyre për shkak të çmimeve jo-normalisht të ulëta është i padrejtë, duke argumentuar se çmimet e ofruara janë rezultat i kapaciteteve profesionale, përvojës së stafit, organizimit efikas të punës dhe shfrytëzimit të burimeve ekzistuese të kompanisë.

Autoriteti Kontraktues, pas shqyrtimit të këtij pretendimi, konstaton se i njëjti nuk qëndron. Në rastin konkret, komisioni i vlerësimit gjatë shqyrtimit të ofertës financiare ka identifikuar disa pozicione me çmime të cilat kanë ngritur dyshime të arsyeshme për realizueshmërinë e tyre, konkretisht pozicionet:

- Pozicioni **I.D.5 Hartimi i Projektit për Rregullimin e Nyjeve të Trafikut (Kryqëzimeve Rrugore)** ju keni vendosur çmimin 50.00 €/Copë;
- Pozicioni **I.D.6 Hartimi i Elaboratit të Shpronësimit për Projektet Rrugor** ju keni vendosur çmimin 20.00 €/km, ose 0.02€/m;
- Pozicioni **I.D.12 Punimi i Elaboratit Gjeomekanik** ju keni vendosur çmimin 15.00 €/m thellësi
- Pozicioni **I.E.8 Hartimi i Projektit Ideor – Impianti për Trajtimin e Ujërave të Zeza (deri 2500 Banorë Ekuivalent – PE)** ju keni vendosur çmimin 500.00 €/copë.
- Pozicioni **I.E.9 Hartimi i Projektit kryesor – Impianti për Trajtimin e Ujërave të Zeza (deri 2500 Banorë Ekuivalent – PE)** ju keni vendosur çmimin 600 €/copë.

Për këto pozicione, në përputhje me nenin 41.6 të Rregullores Nr. 001/2022 për Prokurimin Publik dhe dispozitat për trajtimin e tenderëve jo-normalisht të ulët, Autoriteti Kontraktues i ka kërkuar grupit të operatorëve ekonomik, sqarime me shkrim dhe zbërthim të detajuar të çmimeve të ofruara, përmes formularit përkatës për tenderët jo-normalisht të ulët.

Qëllimi i kësaj kërkesë ka qenë që grupi i operatorëve ekonomik, të ofrojë dëshmi dhe argumente konkrete lidhur me mënyrën e kalkulimit të çmimeve, strukturën e kostove, resurset e angazhuara dhe faktorët ekonomikë që kanë mundësuar ofrimin e këtyre çmimeve.

Megjithatë, grupi i operatorëve ekonomik, nuk ka paraqitur sqarimet e kërkuara brenda afatit të përcaktuar nga Autoriteti Kontraktues. Për pasojë, Komisioni i Vlerësimit nuk ka pasur mundësi ligjore dhe faktike për të analizuar arsyeshmërinë dhe realizueshmërinë e çmimeve të ofruara.

Argumentet e paraqitura nga grupi i operatorëve ekonomik në kërkesën për rishqyrtim, lidhur me kapacitetet profesionale, përvojën, stafin ekzistues dhe organizimin e punës, nuk mund të zëvendësojnë detyrimin e grupit të operatorëve ekonomik (GOE) për të dhënë sqarime brenda procedurës së kërkuar dhe brenda afatit të përcaktuar nga Autoriteti Kontraktues.

Vlerësimi i një oferte me çmime jo-normalisht të ulëta kërkon analizë konkrete të elementeve që kanë ndikuar në formimin e çmimit, përfshirë metodologjinë e realizimit, shpenzimet reale, resurset e nevojshme dhe faktorët ekonomikë. Në mungesë të këtyre sqarimeve në fazën e kërkuar të procedurës, Autoriteti Kontraktues nuk ka pasur mundësi të verifikojë nëse çmimet e ofruara janë të realizueshme dhe në përputhje me kërkesat e kontratës.

Prandaj, vendimi për refuzimin e ofertës nuk është marrë vetëm mbi bazën e nivelit të çmimeve të ofruara, por si pasojë e mosdorëzimit të sqarimeve të kërkuara nga Autoriteti Kontraktues, në kundërshtim me kërkesat procedurale për trajtimin e tenderëve jo-normalisht të ulët.

Në këtë drejtim, **neni 41.7** i Rregullores **Nr. 001/2022** përcakton se:

"Operatori Ekonomik do t'i përgjigjet me shkrim Autoritetit Kontraktues. Nëse jo, tenderi do të refuzohet."

Rrjedhimisht, Komisioni i Vlerësimit ka vepruar në përputhje me dispozitat ligjore në fuqi dhe me kërkesat e Dosjes së Tenderit.

PËRFUNDIM:

Duke qenë se grupi i operatorëve ekonomik, nuk ka ofruar sqarimet e kërkuara brenda afatit të përcaktuar, komisioni i Vlerësimit nuk ka pasur mundësi të vlerësojë arsyeshmërinë dhe realizueshmërinë e çmimeve të ofruara. Rrjedhimisht, oferta e grupit të operatorëve ekonomik, refuzohet në pajtim me **nenin 41.7** të Rregullores **Nr. 001/2022** për Prokurimin Publik.

Autoriteti Kontraktues vlerëson se procedura e vlerësimit është zhvilluar në përputhje me kërkesat e Dosjes së Tenderit, Njoftimit për Kontratë dhe legjislacionit në fuqi, duke siguruar trajtim të barabartë, transparencë dhe vlerësim objektiv të ofertave. Veprimet e ndërmarra nga Komisioni i Vlerësimit kanë qenë në përputhje me kompetencat dhe përgjegjësitë e përcaktuara ligjërisht, ndërsa arsyet e refuzimit të ofertës së grupit të operatorëve ekonomik, janë të bazuara në mosplotësimin e kërkesave të përcaktuara dhe në mosrespektimin e obligimeve procedurale të kërkuara gjatë procesit të vlerësimit.

Për rrjedhojë, duke qenë se pretendimet e paraqitura nuk kanë arritur të dëshmojnë ndonjë shkelje të dispozitave ligjore apo të kërkesave të Dosjes së Tenderit, **kërkesa për rishqyrtim refuzohet në tërësi si e pabazuar.**

Nga konstatimet e lartcekur u vendos si në dispozitave të këtij Vendimi.

Kjo procedurë është trajtuar konform Ligjit Nr. 04/042, Ligji për Prokurimin Publik ne Republikën e Kosovës, i ndryshuar dhe plotësuar me ligjin Nr. 04/L-237, ligjin Nr. 05/L-068 dhe ligjin Nr. 05/L-92.

KËSHILLË JURIDIKE:

Kundër këtij **vendimi të AK-së ju munde të paraqitni** ankesë pranë OSHP-së në pajtim me nenin 109 të LPP-së. Ankesa pranë OSHP-së duhet të dorëzohet brenda 10 (dhjetë) ditëve pas vendimit të lëshuar nga Autoriteti Kontraktues.

Vendimi Publikohet:

Në platformën elektronike në adresën: <https://e-prokurimi.rks-gov.net>